



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

K R Y E T A R I

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 495/25 Prot.

Tiranë, më, 30/09/2017

V E N D I M

Nr. 136, Datë 30/09/2017

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË TROPOJË DHE 7- ISH KOMUNAT:
MARGEGAJ, TROPOJË FSHAT, BUJAN, LLUGAJ, FIERZË, BYTYÇ,
LEKBIBAJ, "MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE
RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Për zbatimin e përputhshmërisë, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare*", të ushtruar në Bashkinë Tropojë dhe 7 ish komunat aktualisht Njësi Administrative në përbërje të Bashkisë Tropojë: Margegaj, Tropojë Fshat, Bujan, Llugaj, Fierzë, Bytyç e Lekbibaj, sipas programit të auditimit nr.495/1, datë 16.05.2017, për veprimtarinë nga data 01.07.2014 deri më 31.12.2016 për Bashkinë Tropojë dhe, nga data 01.01.2013 deri më 31.07.2015 për 7-ish Komunitat.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A.MASA ORGANIZATIVE

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e vlerës së të ardhurave të munguara. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim arkëtimin e vlerës **20,712,880 lekë**, e ardhur e munguar, si më poshtë:

1.-Gjetje nga auditimi: Bashkia Tropojë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, i cili ka si qëllim përcaktimin e rregullave të shkruara të funksionimit të institucionit. Rregullorja e brendshme e funksionimit të administratës, miratuar në vitin 2009 nuk pasqyron ndryshimet ligjore dhe strukturore që kanë ndodhur për shkak të reformës territoriale. Nuk është hartuar rregullore e kodit të etikës, arkivës, regjistri i riskut, gjurma e auditimit, si dhe nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik. Nga Titullari nuk është analizuar funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, duke mos përcaktuar mangësitë që ka dhe masat që duhen marrë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, 16, 22, 23, 24.

1.1-Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë të ngrihet një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, me rregulla të shkruara për secilin sektor dhe drejtori. Të hartohet rregullorja e re e funksionimit të administratës, rregullorja e kodit të etikës, arkivës, regjistri i riskut, si dhe për proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion të hartohet gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës. Të monitorohet nga titullari sistemi i kontrollit të brendshëm, duke bërë përmirësimet e nevojshme në vazhdimësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në territorin e Bashkisë Tropojë ushtrojnë aktivitetet 32 firma të licencuara për nxjerrje e shfrytëzim mineralar, të cilat shfrytëzojnë sipërfaqe të parcelave nga fondi pyjor e kullësor pronë e Bashkisë dhe ish-Komunave. Licencimet e këtyre firmave dhe ushtrimi i aktivitetit nga ana e tyre shtrihet në vitet 1996-2016. Nga Bashkia dhe ish-Komunat deri në korrik të vitit 2016 nuk janë lidhur kontrata qiraje për parcelat dhe rrugët e kalimit në shfrytëzim nga këto subjektet private, në kundërshtim me: ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, nenet 23, pika 7, dhe 26, pika 10; VKM nr.22, date 9.1.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pika 6; UMB nr. 4, datë 22.4.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullësor publik”. Mos lidhja e kontratave me subjektet që shfrytëzojnë lejet minerare në territorin e Bashkisë Tropojë dhe ish-Komunat ka sjellë si pasojë **të ardhura të munguara në shumën 14,440,870 lekë.**

2.1.Rekomandim:

a. Bashkia Tropojë të marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë me subjektet e pajisur me leje minerare për shfrytëzim e nxjerrje të mineraleve, duke vendosur edhe penaltetet përkatëse, si dhe të kërkojë arkëtimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë, në vlerën 14,440,870 lekë, sipas aneksit nr.5, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

b. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në Bashkinë Tropojë, t'i kërkojë Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet

private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullisor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore të mbetura.

c. Për rastet kur nuk është lidhur kontrata e qirasë, nuk është kryer pagesa e detyrimit, si dhe nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në plotësimin e detyrimeve të mësipërme.

Menjëherë

3.-Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Tropojë dhe ish-Komunat: Llugaj, Lekbibaj, Tropojë Fshat, Bytyç dhe Fierzë janë kryer pagesa në vlerën totale **7,813,000 lekë** për ndihmë të menjëhershme, për një numër të konsiderueshëm familjesh dhe në mënyrë periodike, duke përdorur si burim financimi fondin rezerve dhe fondin e emergjencës, fonde të cilat nuk kanë këtë destinacion. Edhe pse këto pagesa janë miratuar në VKB dhe VKK, nga njësitë vendore nuk janë përcaktuar fondet në buxhet për këtë qëllim, nuk janë miratuar kriteret specifike për mbështetje me ndihmë ekonomike apo ndihmë të menjëhershme të familjeve në nevojë, në kundërshtim me: neni 29 pika 9, nenin 31 pika c, të ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shpërblimin shoqëror", i ndryshuar, VKM nr.787, datë 11.12.2005 "Për përcaktimin e procedurave të ndihmës ekonomike" i ndryshuar, nenin 6 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën Shqipërisë", kapitullin II.3 "Buxheti vendor" të UMF nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar. Veprimet e mësipërme kanë shkaktuar **efekt negativ financiar në vlerën totale 7,813,000 lekë**, e ndarë sipas njësive vendore si më poshtë: Bashkia Tropojë për vlerën 1,670,000 lekë, ish Komuna Llugaj për vlerën 1,941,000 lekë, Lekbibaj për vlerën 1,183,000 lekë, Tropojë Fshat për vlerën 1,938,000 lekë, Bytyç për vlerën 198,000 lekë, Fierzë për vlerën 883,000 lekë.

3.1-Rekomandim: Bashkia Tropojë të marrë masa për ndërprerjen e dhënies së ndihmave financiare pa kriter për komunitetin, pasi nuk është ky objektivi e misioni i saj, por të investohet në nxitjen e punësimit nëpërmjet projekteve me bashkëfinancim.

Menjëherë

4.-Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Margegaj, me qëllim zhvillimin e turizmit, në kuadër të projektit "Punët në komunitet III", me fondet e Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës", si kredi për Qeverinë Shqiptare, në Parkun Kombëtar Valbonë, në vitin 2011 është ndërtuar "Qendra e zhvillimit të turizmit" në vlerën 49,849 mijë lekë, ku përfshihet ndërtimi i bujtinave me sipërfaqe 374 m², të shtrira në një sipërfaqe trualli prej 4180 m². Nga ish komuna Margegaj deri në muajin qershor 2015, është lidhur vetëm një kontratë 1 vjeçare në datën 20.01.2014, për sipërfaqen 25 m², duke mos marrë masa për vënien në efikasitet të investimit, me qëllim sigurimin e të ardhurave për njësinë vendore. Nëse investimi do të jepej me qira, vlera e të ardhurave të munguara për ish Komunën Margegaj, për periudhën 2011-qershor 2015 llogaritet në shumën 2,724,480 lekë. Mos vënia në efikasitet e investimit është në kundërshtim me vet objektivin dhe qëllimin e realizimit të këtij investimi, me UMB.nr. 4, datë 22.4.2013 "Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullisor publik", pika 1,3/c,4/h,5,11,19 dhe 24 d/dhe me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" neni 11, pika 4,5 dhe neni 12 pika f. Gjithashtu investimi i mësipërm nuk është vënë në efikasitet as nga Bashkia Tropojë për periudhën qershor 2015-dhjetor 2016, me pasojë të ardhura të munguara në vlerën 1,021 mijë lekë.

4.1-Rekomandim: Bashkia Tropojë të marrë masa për vënien në efikasitet të investimit "Qendra e zhvillimit të turizmit", në Parkun Kombëtar të Valbonës, me qëllim rritjen e të ardhurave dhe promovimin e vlerave turistike të kësaj zone.

Menjëherë

5. -Gjetje nga auditimi: Si rezultat i punës së pamjaftueshme nga zyra e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tropojë, janë krijuar debitorë privat për taksat dhe tarifave vendore (taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndërtesës, ndriçimit), në vlerën totale **4,055,530 lekë**. Kjo vlerë përbëhet nga 8 subjekte debitor të biznesit të madh në vlerën 470,870 lekë, 106 subjekte të biznesit të vogël me vlerë debie 3,584,660 lekë. Mënyra e mbajtjes së debitorëve nuk jep besueshmëri të shifrave, pasi debitorët nuk janë mbajtur në librat e kontabilitetit gjatë vitit dhe nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare çdo fund viti. Nuk ka lista të debitorëve familjar për tokën bujqësore dhe për taksat e tjera, pasi nuk janë hartuar regjistra për taksapaguesit familjar.

Nuk administrohen të dhëna të sakta për pagesat dhe detyrimet për taksat dhe tarifave vendore (taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndërtesës, ndriçimit), të subjekteve që zhvillojnë aktivitet minerar. Për 15 nga këto subjekte ka të dhëna kontradiktore nga kjo zyrë: nuk ekzistojnë në listën vjetore të debitorëve dhe nga ana tjetër, sipas të dhënave të regjistrit të taksave, ka situatë tjetër, këto subjekte rezultojnë debitor në vlerën 1,163,902 lekë.

Nga zyra e taksave nuk është aplikuar taksë trualli, në kundërshtim me nenin nr.9 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

5.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike të kontabilizojë detyrimin prej **4,055,530 lekë** të subjekteve me aktivitet privat. Zyra e taksave dhe tarifave vendore, në bashkëpunim me drejtorinë ekonomike dhe atë juridike, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve tatimore nga këto subjekte në vlerën **4,055,530 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimit tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:**

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në RSH “ të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten në vazhdimësi kamat vonesa.

d-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

e- Zyra e taksave dhe tarifave vendore, të evidentojë dhe njoftojë familjarët për të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, etj., në zbatim të pikës 71, të UMF nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”. Të hartohet regjistri i taksapaguesve familjar.

d. Nga ana e zyrës së taksave Bashkia Tropojë të listohen në mënyrë elektronike **abonentët familjarë** dhe të merren masa për arkëtimin e taksës të tokës **nga fermerë**, taksa e popullatës, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, **të njoftohen** tatimpaguesit familjarë me njoftim vlerësimi tatimor **edhe në median lokale** të Bashkisë Tropojë për të paguar detyrimin tatimor. Njoftim Vlerësimet t’ju dërgohen nëpërmjet Zyrës Postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, ndërtesës dhe tarifave të tjera të pa paguara.

e. Zyra e taksave dhe tarifave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të kryej rakordim me të gjitha subjektet që zhvillojnë aktivitet minerar në territorin e saj, për përcaktimin e saktë të detyrimeve të pa paguara që kanë ndaj bashkisë, si edhe ndaj ish komunave, lidhur me taksat dhe tarifave vendore. Pas këtij rakordimi të hartoj listën përfundimtare të debitorëve për këto subjekte dhe të marrë masa për arkëtimin e tyre.

Të evidentoj subjektet që administrojnë tokë truall, sipërfaqen e miratuar për ndërtim dhe të parashikojë për këtë sipërfaqe aplikimin e taksës mbi truallin.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Lekbibaj dhe në vazhdim nga Bashkia Tropojë nuk është lidhur kontratë qiraje dhe nuk është arkëtuar tarifa e qirasë prej 554,120 lekë në vit, për shfrytëzimin nga subjekti **H...C-Lekbibaj** të sipërfaqes së tokës prej 400 m² të zënë nga ndërtesa, si dhe për sipërfaqen e kanalit 3.8 km, i shtrirë në fondin pyjor e kullësor në zonën kadastrale 1453 në fshatin Curraj, pronë e ish-Komunës Lekbibaj. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9791, datë 23.07.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar me ligjin nr. 9533, datë 15.05.2006, neni 38, germa “q” dhe nenin 40/1-Vlerësimi i dëmit, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pika 4,6 dhe 11, VKM nr. 391, datë 21.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja 2, si dhe ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 11, pika 4,5 dhe neni 12 pika f dhe g, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” pikat 26 e 30, me pasojë **të ardhura të munguara në ish-Komunën Lekbibaj në shumën 2,216,480 lekë**, për periudhën 2013-2016.

6.1. Rekomandim: Bashkia Tropojë të marrë masa për lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin **H...C-Lekbibaj**, si dhe të kërkohet prej tij arkëtimi e vlerës së pashlyer prej **2,216,480 lekë**.

Menjëherë

7.-Gjetje nga auditimi: Për vitin 2015 Bashkia Tropojë nuk ka bërë inventarizim të plotë, por të pjesshëm të pasurisë së institucionit dhe për vitin 2016 nuk ka kryer procesin e inventarizimit. Nga krahasimi i të dhënave të inventarit me bilancin për disa llogari kanë rezultuar diferenca dhe për disa llogari të tjera teprica, për të cilat bashkia nuk ka dalë në konkluzion nëse arsyeja e tyre është për shkak të regjistrimit të gabuar në librat e inventarit, kontabilizimit të gabuar në llogaritë e bilancit, apo nëse këto mos rakordime kanë si shkak edhe mangësi materiale. Në ish komunën Llugaj, një mjet transporti me vlerë 1,700,000 lekë është dorëzuar në Bashkinë Tropojë pas kryerjes së inventarizimit, sipas procesverbalit të datës 16.04.2016. Mjeti edhe pse është marrë në dorëzim nga Bashkia, nuk është bërë hyrje dhe si rezultat nuk është pasqyruar në llogarinë përkatëse të bilancit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e nenin 7, të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, UMF nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pikat 34, 35,37,39,40, 82, 87, 88 ,89, dhe 93. Në mungesë të inventarizimit, llogaritë përkatëse të bilancit që lidhen me inventarët, nuk japin besueshmëri se paraqesin drejtë vlerën e aktiveve.

Për këtë arsye grupi i auditimit nuk jep siguri të arsyeshme përsa i përket vlerësimit dhe kontabilizimit të aktiveve, duke gjykuar se pasuria e institucionit e shprehur në aktivin e bilancit nuk është e saktë.

7.1-Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Tropojë të ngrihet një komision i posaçëm për kryerjen e inventarizimit të përgjithshëm të pasurisë të luajtshme dhe të paluajtshme, duke përfshirë edhe Njësitë Administrative. Të bëhen sistemimet e nevojshme kontabël, dhe për mangësisht materiale të merren masa për zhdëmtimin e tyre nga personat përgjegjës.

Para mbylljes së Pasqyrave Financiare të vitit 2017

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ka punonjës që kryejnë njëkohësisht dy detyra, veprime të cilat nuk garantojnë kryerjen e detyrës funksionale dhe realizimin e objektivave prej tij, si dhe ulin performancën e institucionit. Mbivendosja e funksioneve dhe

përgjegjësi sjell një risk të lartë dhe hapësira për të mos përmbushur misionin kryesor të detyrës nga punonjësi. Kjo situatë e përsëritur në tre vjet, tregon një nënvlerësim të sektorit të taksave dhe tarifave vendore nga titullari i institucionit.

Konkretisht në pozicionin e përgjegjësit të taksave dhe tarifave vendore është caktuar punonjësi i QKR, i cili nuk është në strukturë të bashkisë, por funksion i deleguar në këtë institucion; Përgjegjës i sektorit të shërbimeve kryen njëkohësisht edhe detyrën e inspektorit të mbrojtjes së territorit dhe mjedisit.

8.1-Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë, të marrë masa për plotësimin e stafit, në mënyrë që në strukturën e funksionimit të administratës të mos ketë persona të cilët kryejnë dy detyra funksionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.-Gjetje nga auditimi: Për transferimin e dokumentacionit nga ish komunat në bashki, si rezultat i reformës territoriale, është ngritur grupi i punës për këtë qëllim, i cili nuk ka vepruar sipas kërkesave dhe afateve që përcakton VKM 510, datë 10.6.2015 *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”*

Si rezultat nuk ka përfunduar dorëzimi i të gjithë dokumentacionit nga ish komunat. Edhe pse është dokumentuar dokumentacioni i dorëzuar deri tani, nuk ka njohje të saktë të situatës, rakordim midis ish komunave dhe bashkisë, nëse është tërhequr përfundimisht i gjithë dokumentacioni që ka qenë i administruar nga ish komunat.

9.1-Rekomandim: Bashkia Tropojë, pasi të nxjerrë përgjegjësitë, të marrë masa nëpërmjet grupit të punës të ngritur në zbatim të VKM 510, datë 10.6.2015, për transferimin e të gjithë dokumentacionit nga ish komunat në arshivën e bashkisë, sipas rregullave që përcaktohen në këtë VKM, si dhe rregullave të arshivës. Të kërkohet nga bashkia inventari i arshivës së secilës komunë dhe të kryhet dorëzimi i dokumentacionit bazuar në këtë inventar dhe jo mbi faktin se çfarë dorëzojnë vet ish komunat. Në përfundim të procesit të hartohen procesverbale përfundimtare të dorëzimit dhe të deklarohet me shkrim nga Administratorët e Njësive Administrative se në ambientet e tyre nuk ka më dokumentacion për transferim.

Menjëherë

10.-Gjetje nga auditimi: Bashkia Tropojë nuk ka gjetur forma efikase për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë e taksapaguesve familjar. Edhe pse është aksionere e shoqërisë “Ujësjiellës” sh.a Tropojë dhe për vitin 2016 kanë pasur përfaqësues në Këshillin Administrativ, nuk ka mundur lidhjen e një marrëveshje, në të cilën “Ujësjiellësi” sh.a. Tropojë, të përcaktohet si agjent tatimor për arkëtimin e taksave vendore së bashku me faturën e ujit të pijshëm, bazuar kjo mundësi në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore”* i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 *“Për Procedurat Tatimore”* i ndryshuar. Kjo marrëveshje do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do gjeneronte të ardhura për Bashkinë Tropojë.

10.1.-Rekomandim: Bashkia Tropojë të përgatisë aktmarrëveshje me shoqërinë “Ujësjiellësi” sh.a. Tropojë, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

11.-Gjetje nga auditimi: Nisur nga shqetësimi i qytetarëve, paraqitur pranë KLSH gjatë procesit të auditimit, u shqyrtuan dy ankesa:

1. Ankesa, nr.10/360 , datë 19.06.2017, nga qytetarët **Gj. D.**, me AMTP nr.7, datë 18.10.1998, **N. D.**, me AMTP nr.20, datë 18.10.1998, **Z. H.**, me AMTP nr.7 (në emër të babait të tij, z. **P. H.**), me objekt pretendimin se Bashkia Tropojë nuk ju bën rikonfirmim të akteve të marrjes së tokës në pronësi (AMTP). Në përfundim të shqyrtimit të ankesës u arrit në përfundimin se:

Bashkia Tropojë ka shqyrtuar ankesën e qytetarëve të mësipërm gjatë muajit mars të vitit 2017 dhe bazuar në dokumentacionin dhe verifikimin në terren, ka dalë në konkluzionin se AMTP e qytetarëve përmbajnë sipërfaqe toke më shumë nga sa parashikon ligji 7501 “Për tokën”, është nënshkruar jo nga personi i duhur i komisionit të ndarjes së tokës, si dhe kanë mangësi të paraqitjes topografike në hartë.

Nga auditimi u konstatua se AMTP e tre personave ankimes përmbajnë edhe sipërfaqe “tokë truall”, e cila nuk është në zërin kadastral tokë bujqësore, në kundërshtim me nenin nr.2, pika 1, germa a, të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", element i pa trajtuar nga Bashkia Tropojë. Gjithashtu në dokumentacionin e ankesës, paraqitur nga qytetarët , mungon vërtetimi nga ish njësia vendore Llugaj për normën e tokës bujqësore në m² për frymë, për fshatin Bukovë më datën 1.8.1991, si dhe vërtetimi nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tropojë, nëpërmjet të cilit konfirmohet nëse tre familjet e mësipërme kanë qenë ose jo më datën 1.8.1991 anëtarë të ish-kooperativës bujqësore. Këto mungesa nuk japin mundësinë e gjykimit nëse sipërfaqja e tokës bujqësore në AMTP e qytetarëve është e saktë, në përputhje me kërkesat e ligjit 7501 “Për tokën” dhe VKM nr.255, datë 2.8.1991 në zbatim të tij.

2. Ankesa nr.699 prot., datë 19.06.2017 nga qytetarët **F.D. M.D B.D. Q.D. R.D.** me objekt çështje pronësie të këtyre banorëve me të tretë, për të cilën palët sqarojnë se i janë drejtuar gjykatës dhe si rrjedhim është objekt shqyrtimi i kësaj të fundit.

11.1-Rekomandim: Bashkia Tropojë, të kërkojë pranë Drejtorisë së KVVTP në Institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës, verifikimin e vlefshmërisë ligjore të akteve të marrjes së tokës në pronësi (AMTP): nr.6, nr.7 dhe nr.20, datë 18.10.1998. Pas përfundimit të procesit të njoftohen ankimesit dhe KLSH për rezultatin e vendimit.

Menjëherë

12.-Gjetje nga auditimi: Për periudhën janar 2013-qershor 2016 në ish-Bashkinë Bajram Curri dhe ish-komunat Llugaj, Tropojë Fshat, Bujan, Bytyç, janë kryer pagesa për shpërblimin e këshilltarëve për çdo muaj në mungesë të listë-prezencave të pjesëmarrjes së këshilltarëve në mbledhje, si dhe pa bërë verifikim nëse këshilltarët kanë qenë pjesëmarrës në mbledhjet e këshillit. Nuk u paraqit dokumentacion nga ish Komunat Margegaj, Fierzë dhe Lekbibaj për këtë qëllim. Grupi i auditimit gjykon se pagesat nga zyra e financës janë realizuar pa dokumentacionin e nevojshëm vërtetues, listë-prezencën dhe protokollin e mbledhjeve. Me dokumentacionin jo të plotë të paraqitur, u konstatua një vlerë prej 6,389,218 lekë, pagesë për këshilltarët, për të cilën dokumentacioni vërtetues nuk është i sakt. Në mungesë të dokumentacionit të plotë, vlera e mësipërme nuk jep besueshmëri dhe për këtë arsye grupi i auditimit nuk jep siguri të arsyeshme për sa i përket rregullshmërisë ligjore të ndjekur nga njësitë vendore, në pagesën e këshilltarëve të bashkisë dhe 7 ish komunave.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2; neni 31, pika 2 dhe pika 8.

12.1-Rekomandim: Në kushtet e pamundësisë nga KLSH të verifikimit rast pas rasti të dokumentacionit dhe protokolleve të mbledhjeve për pagesat e këshilltarëve të ish-Komunave dhe Bashkisë, mbështetur në shkronjat (i) dhe (f) të nenit 15, -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; sipas të cilit “KLSH ka të drejtë ti propozojë njësitë të auditimit të brendshëm në sektorin publik të kryejnë auditime brenda kompetencës të tyre” ; neni 25-Marrëdhëniet me

Kontrollin e Lartë të Shtetit, të ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe ISSAI 1600, rekomandojmë:

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Tuaj (dhe në mungesë të kësaj strukture të ngrihet një komision me pjesëmarrjen e punonjësve të financës, ish-sekretari i këshillit dhe këshilltarëve), në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të verifikojë të gjithë dokumentacionin mbi të cilin është bërë pagesa e këtyre këshilltarëve.

Pas verifikimit dhe saktësisimit të këtyre pagesave, **i lihet në kompetencë Kryetarit të Bashkisë**, të përcaktojë masat përkatëse në lidhje me vlerën e dëmit që duhet të kthejnë në buxhet këshilltarët. Ndalesat që bëjnë fjalë për mos llogaritjen e tatimit mbi pagë duhet te paguhen, pasi janë në kundërshtim me kërkesat e kreut II-të, neni 8 “E ardhur e tatueshme” shkronja “g”, neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar me ligjin nr. 83/2014 datë 17.07.2014 dhe 156/2014 datë 27.11.2014.

Menjëherë

13.-Gjetje nga auditimi: Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, kryer në vitin 2014, në Bashkinë Tropojë dhe ish komunën Margegaj, Lekbibaj, Tropojë Fshat, u konstatua se:

a- Në Bashkinë Tropojë nga 19 masa organizative, 5 prej tyre përmbajnë detyrime për arkëtime vlerash financiare prej 3,357,324 lekë, realizuar pjesërisht dy, në vlerën 222,970 lekë, ose në masën 7%, pa u zbatuar tre masa. Nga masat organizative pa u arkëtuar vlera 3,134,354 lekë.

Nga 7 masa shpërblim dëmi me vlerë 15,739,640 lekë, është zbatuar vetëm një në vlerën 3,000 lekë, pa u zbatuar 6 masa, në vlerën 15,736,640 lekë. Si rezultat i moszbatimit të masave organizative dhe atyre shpërblim dëmi, është pa u arkëtuar vlera **18,873,994 lekë**.

b- Në ish Komunën Margegaj, nga 11 masa organizative të rekomanduara dy prej tyre përmbajnë detyrime për arkëtime vlerash financiare prej 2,100,000 lekë, të cilat rezultojnë të pa zbatuara. Është dhënë 1 masë për shpërblim dëmi me vlerën 4,393,043 lekë, e cila rezulton e pa zbatuar.

c- Në ish Komunën Lekbibaj, nga 15 masa organizative të rekomanduara, tre prej tyre përmbajnë detyrime për arkëtime vlerash financiare prej 1,471,000 lekë, të cilat nuk janë zbatuar. Nga 13 masa për shpërblim dëmi, në vlerën 3,665,211 lekë nuk është zbatuar asnjë.

d- Në ish Komunën Tropojë Fshat, nga 15 masa organizative të rekomanduara, një prej tyre përmban detyrime për arkëtime vlerash financiare prej 488,920 lekë, e cila rezulton e pa zbatuar. Nga 5 masa për shpërblim dëmi në vlerën 20,792,566 lekë, është zbatuar pjesërisht 1 masë në vlerën 32,253 lekë. Pa u zbatuar plotësisht 4 masa. Mbetet pa u arkëtuar vlera 20,760,313 lekë.

13.1-Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të pazbatuara deri tani në Bashkinë Tropojë dhe 3-ish komunat: Margegaj, Lekbibaj e Tropojë Fshat.

Menjëherë

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i Njesisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me

qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **24,799,304 lekë**, si më poshtë:

I. Bashkia Tropojë

1.-Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “*Rikonstruksion i Godinës së Bashkisë Tropojë*”, me vlerë të kontratës bazë 39,995,986 lekë me tvsh dhe vlerë të kontratës shtesë 7,990,680 lekë me TVSH, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **795,072 lekë, dëm ekonomik**, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr.4 prot., datë 21.12.2015 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tropojë dhe OE “*Sh...I*” sh.p.k. Gjithashtu në këtë tender, për pajisjet nuk është bërë zbritja e TVSH, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **832,032 lekë**, në kundërshtim me: UKM nr.2 datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” në zbatim të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, i ndryshuar, me UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

1.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,627,104 lekë**, nga operatori ekonomik “*Sh...I*” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit, për mos zbatim të kontratës sipërmarrjes së punimeve nr.4 prot., datë 21.12.2015 dhe mos zbritje të vlerës së TVSH për pajisjet.

Menjëherë

2.-Gjetje nga auditimi: Nga ish-Bashkia Bajram Curri për periudhën dhjetor 2013- qershor 2015, për 25 muaj janë kryer pagesa për bonus transporti për ish-Kryetarin e Bashkisë z. **A. D**, në kundërshtim me ligjin nr.169/2013, datë 7.11.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë” neni 4, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **480,000 lekë**.

2.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **480,000 lekë** të përfituar padrejtësisht nga ish-Kryetari i Bashkisë Bajram Curri z. **A. D**.

Menjëherë

3.-Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Tropojë për periudhën 2013-2016 në 14 raste vlera e ndërtimit të objektit sipas preventivit të paraqitur, nuk është llogaritur duke u bazuar në manualët teknike të çmimit të punimeve të ndërtimit sipas VKM-së përkatëse, ose çmimit për m² sipërfaqe ndërtimi sipas EKB-së. Duke ju referuar të dhënave të projektit dhe çmimit për m² sipas EKB-së rezulton se vlera e ndërtimit të objektit është më e lartë se ajo e përlllogaritur sipas preventivit apo situacionit përfundimtarë, për rrjedhojë aplikuesit kanë paguar më pak për taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 923,868 lekë dhe tarifën e aplikimit për leje zhvillimi në vlerën 75,594 lekë, të cilat përbëjnë dëm ekonomik në shumën **999,462 lekë** për buxhetin e njësisë vendore Bashkia Tropojë.

3.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **999,462 lekë** nga personat sipas tabelës hartuar në pikën IV/8.a “Mbi planifikimin dhe zhvillimit të territorit”, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, faqe 152-161.

Menjëherë

4.-Gjetje nga auditimi: Bashkia Tropojë për dhënien me qira të sipërfaqes prej 150 m2 të objektit “Kati i parë, Muzeu i Rrethit Tropojë”, ka lidhur kontratën nr.1772, datë 27.04.2016, me afat kohor 1-vjeçar, me subjektin **V. H.**, me tarifë mujore prej 15,000 lekë/muaj. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ky subjekt deri me datë 31.12.2016 nuk ka paguar detyrimin kontraktor në shumën **120,000 lekë**, në kundërshtim me nenin 3 të kontratës së mësipërme.

4.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktor të pashlyer prej 120,000 lekë nga subjekti privat **V. H.**, në rast mospagese të mos rinovohet kontrata për periudhën e mëvonshme.

Menjëherë

II. Ish Komuna Margegaj

5.-Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Margegaj për periudhën 01.01.2014-31.07.2015, në 5 raste, janë kryer blerje me vlera të vogla për mallra, punime e mirëmbajtje, në vlerën totale 1,985,171 lekë, me procedurë emergjence (shkresore). Gjithashtu në 12 raste janë kryer blerje me vlera të vogla për kryerje punimesh e mirëmbajtjesh në vlerën totale 2,068,000 lekë. Procedurat e mësipërme rezultonë fiktive, sepse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton ndodhjen e ngjarjes ekonomike, dokumentet financiare urdhërues dhe vërtetues kanë mangësi, nuk kanë rrjedhë kronologjike në kohë, midis tyre ka mos rakordim të datave, mungon argumentimi i nevojës së blerjes së mallit apo punës që do të kryhet, në urdhrat e prokurimit objekti i prokurimit është i paqartë, pa adresim të vendin se ku do të kryhen punimet, veprime të cilat nuk vërtetojnë se malli është blerë dhe puna është kryer, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **4,053,171 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 1, neni 3/9, neni 23/4; me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu i VI pikës 2/a; me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” neni 40, UMF nr. 57 datë 12.06.2014 “Për gjurmën standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, tabela 1/3, me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/4, neni 12/3; me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35,36,37,38, 42,43 dhe 44,52,54; U d h ë z i min nr. 2, datë 28.03.2013 për procedurën e prokurimit me vlera të vogla.

5.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **4,053,171 lekë**, duke kërkuar pagesën e vlerës së njëjtë **810,634 lekë** nga secili person si më poshtë:

- z. **R. B.** me detyrë ish Kryetar Komune, në cilësinë e titullarit të AK;
- znj. **Z. I.** me detyrë ish përgjegjëse finance, në cilësinë e anëtares së KPVV;
- znj. **Z. I.** me detyrë përgjegjëse e gjendjes civile në cilësinë e anëtares së KPVV;
- z. **E. A.** me detyrë specialist shërbimesh, në cilësinë e anëtarit të KPVV;
- znj. **S. B.** në cilësinë e preventivueses.

Menjëherë

6.-Gjetje nga auditimi: Me urdhër-shpenzimit nr.52, datë 15.06.2015 është tërhequr me çek nga banka (mungon mandat pagesa e bankës) vlera **2,000,000 lekë**. Sipas mandat-arkëtimit nr.1 datë 20.06.2015, kjo vlerë është arkëtuar në arkën e komunës nga znj. **Z. I.**, e cila nuk ka këtë detyrë funksionale, por është punonjëse e gjendjes civile dhe nuk dihen arsyet e përfshirjes në këtë transaksion. Mandat arkëtimi i mësipërm është konfirmuar edhe nga znj. **Z. I.** ish përgjegjëse e financës. Në datën 27.06.2015, sipas mandat-pagesës nr.1, nënshkruar nga znj. **Z. I.** dhe konfirmuar nga znj. **Z. I.**, është bërë dalje nga arka vlera 2,000,000 lekë, ku për të argumentuar destinacionin e pagesës, është bërë përshkrimi: “*Sipas bordersë bashkëngjitur*”. Nga auditimi konstatohet se:

- Borderoja, e cila ka emrat e 34 qytetarëve përfitues dhe vlerat përkatëse, e përbërë prej dy fletë, është fotokopje, jo dokument origjinal, si dhe përmban vulën e komunës, emrin dhe firmën e ish kryetarit të komunës z. **R. B.**, emrin dhe firmën e ish përgjegjësës së financës znj. **Z. I.**, vetëm në fletën e dytë, në fletën e parë mungojnë këto të dhëna. Të gjithë elementët në këtë dokumentë, si vula, firmat etj., janë **fotokopje**, në kundërshtim me nenin nr.4, pika 26 të ligjit 10296 date 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ku thuhet "*Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike*".

- Lista e familjeve përfituese nuk është miratuar me vendim të këshillit të komunës.

- Nuk është nxjerrë urdhër nga titullari për realizimin e transaksionit të mësipërm.

- Nuk vërtetohet me mandat pagese të arkës së komunës, pagesa e personave përfitues të vlerës së mësipërme. Në vend të mandat pagesës nga Komuna Margegaj është paraqitur dokument dore në format A4, **fotokopje**, jo origjinal, ku është shënuar emri i personit, vlera në lekë, data, firma e përfituesit, vula e komunës, firma e ish kryetarit të komunës dhe ish përgjegjësit të financës. **Ky dokument nuk vërteton përfitimin e vlerës 2,000,000 lekë nga 34 familjet në nevojë, për arsye se:**

a-Nuk është dokument origjinal, por fotokopje, në kundërshtim me nenin nr.4, pika 26 të ligjit 10296 date 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ku thuhet "*Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike*".

b-Nuk është dokument arke, pasi në rastin konkret duhet të ishte prerë mandat pagesë arke për secilin person. Dokumenti i paraqitur nga komuna nuk vërteton kryerjen e veprimit të arkës, pasi është në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”ku thuhet: “ *Veprim arke është shërbimi i arkëtimit dhe i pagesës me para në dorë që bëhet në të gjitha nivelet e njësisë publike, në bazë të mandat arkëtimit ose të mandat pagesës*”.

c- Dokumenti nuk përshkruan shkakun e veprimit, pasi nuk ka asnjë përshkrim të tillë, në kundërshtim me kërkesat e paragrafit nr.36, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”ku thuhet: “*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit*”

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, date 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/4, neni 12/3, me UMF nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35,36,37 dhe 44,52,54, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 2,000,000 lekë.**

6.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **2,000,000 lekë** nga personat e mëposhtëm:

-z. **R.B.** me detyrë ish Kryetar Komune, arkëtimin e vlerës **666,667 lekë;**

-znj. **Z.I.** me detyrë ish përgjegjëse e financës arkëtimin e vlerës **666,667 lekë;**

-znj. **Z.I.** me detyrë punonjëse e gjendjes civile në vlerën **666,667 lekë.**

Menjëherë

7.-Gjetje nga auditimi: Nga ish Komuna Margegaj nuk është bërë dorëzimi i aktiveve në Bashki në përfundim të procesit të mbylljes së komunës për shkak të reformës territoriale. Nga inventarizimi i kryer në fund të vitit 2015 ka rezultuar mangët artikulli blerje projektsh me vlerën **2,400,000 lekë**, me pasojë dëm ekonomik. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 9 dhe 12 dhe ngarkojnë me përgjegjësi materiale ish Kryetarin e Komunës z. **R. B.**, në cilësinë e nëpunësit autorizues, si dhe znj. **Z. I.**, me detyrë ish përgjegjëse e financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

7.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **2,400,000 lekë**, konkretisht:

-nga z. **R. B** me detyrë ish Kryetar i Komunës të kërkojë arkëtimin e vlerës 1,200,000 lekë;

-nga znj. **Z. I.** me detyrë ish përgjegjëse e financës të kërkojë arkëtimin e vlerës 1,200,000 lekë.

Menjëherë

8.-Gjetje nga auditimi: Në objektin e prokurimit “*Hapje rruga Auto, Kika-Cerem- Markofcë-Bjeshkët e rrethit Tropojë*”, zhvilluar në ish Komunën Margegaj, me vlerë të fondit limit 2,500,000 lekë pa tvsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të hartimit të preventivit të punimeve rezultoi një rritje fiktive e fondit limit në vlerën **284,397 lekë**, si pasojë e zvogëlimit të volumeve dhe mos ndryshimit të vlerës së preventivit gjatë ftesës për ofertë nga ish Titullari, si dhe rritjes së çmimeve gjatë hartimit të preventivit të fondit limit. Këto veprime janë në kundërshtim me Vendimi nr.514, datë 15.08.2007 “*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.08.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat 2, 3 dhe 9.*

8.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **284,397 lekë**, nga e cila vlera 253,209 lekë nga z. **E. M.**, me detyrë ish N/Kryetar i Komunës Margegaj, në cilësinë e ish Titullarit i AK, vlera 31,188 lekë nga znj. **S. I.**, në cilësinë e hartueses së projekt-preventivit të punimeve.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Margegaj për vitin 2014, në dy raste janë kryer shpenzime me objekt të njëjtë: “*Mirëmbajtje kanale ujitëse, Fshati Shoshan*”, në një hark kohor prej 2 muaj. Blerja e këtij shërbimi në rastin e parë është kryer me procedurë prokurimi elektronike në datën 23.06.2014 në vlerën 295,000 lekë, ndërsa në rastin e dytë është kryer me procedurën e emergjencës (në rrugë shkresore), në datën 30.08.2014, me vlerë 399,700 lekë.

Në të dy rastet nuk është përcaktuar saktë e në mënyrë të plotë objekti i prokurimit, situacioni është i pa shoqëruar me projekt-skicë dhe plan-vendosje të kanalit, përmasa etj., të dhëna të nevojshme për llogaritjen e fondit limit. Në dokumentacionin e rastit të emergjencës rezultuan mangësi e parregullsi të dukshme, në aspektin e kronologjisë kohore të hapave të ndjekur dhe lënies së gjurmës së auditimit, duke i bërë ato kontradiktore, duke mos vërtetuar kryerjen e shërbimit me këtë procedurë, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën **399,700 lekë**. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” neni 4/26,12 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik*” pika 35,36,38.

9.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **399,700 lekë**, duke kërkuar arkëtimin e vlerës së njëjtë prej 79,940 lekë, nga secili person si më poshtë vijon:

-z.**R. B.** me detyrë ish Kryetar Komune, në cilësinë e titullarit të AK;

-znj.**Z. I.** me detyrë ish përgjegjëse finance, në cilësinë e anëtares së KPVV;

-znj.**Z. I.** me detyrë përgjegjëse e gjendjes civile në cilësinë e anëtares së KPVV;

-z.**E. A.** me detyrë specialist shërbimesh, në cilësinë e anëtarit të KPVV;

-znj.**S. B.** në cilësinë e preventivueses.

Menjëherë

10.-Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Margegaj në 2 raste, janë kryer pagesa për blerje mallrash dhe shërbimesh në vlerën totale 471,000 lekë, me urdhër-shpenzimin nr.45 datë 20.05.2014 dhe nr.126, datë 13.11.2014. Nga auditimi i procedurave me blerje të vogla për

blerjen e këtyre mallrave u konstatua se KPVV ka skualifikuar OE me vlerën më të ulët, në vend të parë dhe që i plotëson kriteret e vendosura në ftesën për ofertë dhe, ka kualifikuar ofertën me vlerën më të lartë në vendin e pestë. Skualifikimi i OE nuk është argumentuar me procesverbal dhe nuk ka korespondencë me mesazhe në sistemin elektronik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VI pikës 2/a; Udhëzimin e APP nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”; Urdhrin e MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për Gjurmën standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela 1/3, me pasojë dëm ekonomik në shumën **103,000 lekë**.

10.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **103,000 lekë** nga anëtarët e KPVV: znj.**Z. I.**, znj.**Z. I.**, z.**E. A.**, në vlerë të barabartë prej 34,333 lekë për secilin.

Menjëherë

11.-Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Margegaj në 2 raste, me urdhër-shpenzimet: nr.65 datë 20.05.2014 në vlerën 289,000 lekë dhe nr.29 datë 09.04.2015 në vlerën 100,000 lekë, janë kryer pagesa për blerje me vlera të vogla të materialeve të ndryshme. Për të dy rastet fatura e furnitorit ka vlerë më të ulët se vlera e urdhër shpenzimit: në rastin e parë në vlerën 79,000 lekë dhe në rastin e dytë në vlerën 23,000 lekë, duke u paguar furnitori me vlerë më të lartë se vlera reale e faturës, në shumën **102,000 lekë**, dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26,12 dhe me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35,36,38.

11.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **102,000 lekë**, duke kërkuar nga secili person i mëposhtëm arkëtimin e vlerës 51,000 lekë nga z.**R. B.** me detyrë ish kryetar komune, në cilësinë e titullarit të AK dhe znj. **Z. I.** me detyrë ish përgjegjëse e financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Menjëherë

III. Ish Komuna Lekbibaj

12.-Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Lekbibaj në 10 raste të blerjeve me vlera të vogla për punime e mirëmbajtje të rrugëve, kanaleve vaditëse e varrezave, mirëmbajtje ujësjellësi, përmirësime pyjore etj., nuk është argumentuar nevoja e blerjes, nuk është përcaktuar i plotë objekti i prokurimit, preventivat apo situacionet janë të pa shoqëruara me projekt-skicë dhe plan vendosje, si dhe mungon akti marrjes në dorëzim i punimeve në shumicën e rasteve. Këto mangësi nuk vërtetojnë kryerjen në fakt të punëve apo shërbimeve, me pasojë dëm ekonomik në shumën **2,487,760 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, neni 3/9, neni 23/4; me UKM nr. 2 datë 13.05.2005 kreu I pika 3.1 dhe 8.3, në zbatim të ligjit nr 8402, datë 17.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar; me Urdhrin MF nr. 57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela 1/3.

12.1-Rekomandim: Bashkia Tropojë të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **2,487,760 lekë**, duke kërkuar pagesën e vlerës **621,940 lekë** nga secili prej personave të mëposhtëm:

-z.**G. M.**, me detyrë ish Kryetar i Komunës Lekbibaj, në cilësinë e titullarit të AK;

-znj.**V. Rr.**, me detyrë ish përgjegjëse e financës, në cilësinë e anëtares së KPVV;

-z.**M. N.**, me detyrë ish përgjegjës i administratës e kadastrës, në cilësinë e anëtarit të KPVV;

-z.**V. L.**, me detyrë ish jurist i komunës, në cilësinë e anëtares së KPVV.

Menjëherë

13.-Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2014-2015 ish kryetari i Komunës Lekbibaj, z.**G. M.** rezulton se ka blerë për nevoja të komunës materiale të ndryshme, për të cilat nuk ka asnjë dokument të bërë hyrje apo dalje. Vlera totale e tyre sipas inventarit është 500,790 lekë. Gjithashtu ai nuk justifikon me dokumentacion edhe për dy çadra me vlerë 400,000 lekë, duke krijuar një detyrim total në vlerën **900,790 lekë**, dëm ekonomik.

13.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **900,790 lekë** lekë, nga ish kryetari i Komunës, z. **G. M.**

Menjëherë

14.-Gjetje nga auditimi: Nga z. **J. M.** me detyrë ish sekretari i komunës Lekbibaj, i cili ka ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 30.07.2015, përpara largimit nuk është bërë dorëzimin e detyrës dhe inventarit në ngarkim: një kompjuter në vlerën 44,500 lekë dhe një printer në vlerën 12,000 lekë, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 13, që e ngarkojnë me përgjegjësi materiale në vlerën totale **56,500 lekë**.

14.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa, dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës **56,500 lekë**, nga z. **J. M.**

Menjëherë

IV. Ish Komuna Fierzë

15.-Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “*Rruga auto Degë-Rushtë (hapja e trasesë)*” Komuna Fierzë, me fond limit 4,166,667 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2013, KVO dhe Titullari i AK, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues OE “**V...i**” shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 4,142,638 pa TVSH i cili nuk plotëson kriteret e DST, dhe kanë s’kualifikuar padrejtësisht OE “**T...i**” shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 3,353,857 lekë pa TVSH, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **788,781 lekë** si diferencë midis dy ofertave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1, pika b, d, dh; -nenin 2, pika a, c; nenin 53 pika 5; nenin 55, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

15.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **788,781 lekë**, duke kërkuar pagesën e vlerës *197,195 lekë nga secili* prej personave e mëposhtëm:

-z. **Gj. P.**, me detyrë ish Kryetar i Komunës Fierzë, në cilësinë e titullarit të AK

-z. **S. I.**, me detyrë ish përgjegjës i financës në Komunën Fierzë, në cilësinë e kryetarit të KVO,

-z. **B. P.**, me detyrë punonjës shërbimesh në NJA Fierzë, në cilësinë e anëtarit të KVO;

-znj. **M. P.**, me detyrë punonjëse e gjendjes civile në NJA Fierzë, në cilësinë e anëtares së KVO.

Menjëherë

16.-Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rruga auto Degë-Rushtë (hapja e trasesë), Komuna Fierzë*”, me vlerë të fondit limit 4,166,666 lekë pa TVSH, nga auditimi i dokumentacionit teknik të hartimit të preventivit të punimeve rezultoi një rritje fiktive e fondit limit në vlerën 598,269 lekë pa tvsh nga të cilat vlera **565,241 lekë** përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.08.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat 2, 3 dhe 9.

16.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **565,241 lekë** nga z. **H. Ç.** dhe **U. K.** në cilësinë e hartuesve të projekt-preventivit të punimeve, në vlerë të barabartë prej **282, 620 lekë** nga secili. “*Rruga auto Degë - Rushtë (hapja e trasesë), Komuna Fierzë*”.

Menjëherë

17.-Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “*Rikonstruksion i rrugës auto Kishë-Pepkolaj*”, ish Komuna Fierzë, zhvilluar në vitin 2013, në preventivin e hartuar nga AK së bashku me zërin e punimeve është vendosur si shpenzim në projekt preventiv edhe vlera e mbikëqyrjes së punimeve dhe kolaudimit, veprime fiktive, të pakryera në fakt, pasi kontraktori nuk mund të mbikëqyrë punimet e veta për llogari të njësisë vendore, në kundërshtim me UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit. Këto veprime kanë sjell përfitimin padrejtësisht nga OE “**H...i**” shpk, në cilësinë e kontraktorit të **vlerës 286,854 lekë**, dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore.

17.1.Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 286,854 lekë** nga subjekti “**H...i**” shpk, në cilësinë e kontraktorit.

Menjëherë

VI.Ish Komuna Llugaj

18.-Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Llugaj është bërë blerje materiale tub çeliku Ø 880, 26 ml, me vlerë 146,400 lekë nga OE “**H...i**” shpk nëpërmjet faturës nr.315 datë 01.09.2014. Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se malli nuk është marrë në dorëzim dhe nuk është bërë hyrje në magazinë. Likuidimi i faturës së mësipërme është shkelje e disiplinës financiare, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **146,400 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, date 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/4, neni 12/3, me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35,36,37,38, 42,43 dhe 44,52,54.

18.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **146,400 lekë** nga z. **A. O.** me detyrë ish përgjegjës finance në ish Komunën Llugaj.

Menjëherë

VII. Ish Komuna Bujan

19.-Gjetje nga auditimi: Nga inventarizimi i kryer në vitin 2015, sipas urdhrit nr.114, datë 30.12.2015 të titullarit të Bashkisë Tropojë, në ish Komunën Bujan, në shkollën “Jaho Sali”, në përfundim të inventarit ka rezultuar mangut 1 kompjuter me vlerën **47,738 lekë**, me përgjegjës material z. **P. P.**, i cili ngarkohet me përgjegjësi materiale për zhdëmtimin e vlerës së mësipërme.

19.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës **47,738 lekë**, nga z. **P. P.**

Menjëherë

Shkelje të përbashkëta për ish Komunitat

20.-Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komunitat Margegaj dhe Lekbibaj janë lidhur 6 kontrata të dhënies me qira të parcelave të fondit pyjor, pronë e ish-komunave, për ndërtim e vendosje të stacioneve nga shoqëritë “**A...C**”, “**V...n**” dhe “**E..e M...e**”. Nga auditimi i dokumentacionit financiar rezulton se për periudhën 2015-2016 shoqëritë “**A...C**”, sot “**T...m A...a**” sh.a. dhe

“E...e M...e”, nuk kanë shlyer detyrimet në kundërshtim me pikat 4 dhe 5 të kontratave, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën **2,400,000 lekë**.

20.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa, dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës **2,400,000 lekë** përkatësisht: nga shoqëria “A...C”, sot “T...m A...a” sh.a., vlera prej 1,200,000 lekë; nga Shoqëria “E...e M...e”, vlera prej 900,000 lekë; dhe nga shoqëria “V...n” vlera prej 300,000 lekë.

Menjëherë

21.-Gjetje nga auditimi: Nga ish Komuna Fierzë, Bujan dhe Llugaj, për periudhën 2013-2015, në hartimin e preventivit të tenderave janë llogaritur përveç zërit të punimeve, edhe vlera e projekt-preventivit, supervizimit dhe vlera e kolaudit, i cili është veprim fiktiv, pasi nuk është kryer prej tij. Kontraktori nuk mund të supervizoj dhe kolaudoj punimet e veta, për llogari të investitorit. Konkretisht ky fenomen ka ndodhur në 1 rast në ish-Komuna Fierzë në vlerën 637,197 lekë, në 2 raste në vlerën 605,093 lekë në ish Komunën Bujan, në 1 rast në vlerën 2,138,566 në ish-Komuna Llugaj. Likuidimi i këtyre zërave nga ish njësitë vendore ka shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën totale **3,380,856 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin e disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 4,5,7,8 dhe12, me piken 3/1 dhe 4/c të UKM nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit të ndryshuar.

21.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa, dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës **3,380,856 lekë** nga:

a. Shoqëria “D...i” shpk për vlerën 637,197 lekë, për objektin “Rikonstruksion shkolla e Mesme Dushaj, Komuna Fierzë”.

b. Shoqëria “P...U” shpk për vlerën 605,093 lekë për 2 objektet:

- “Ndërtim i Zyrave Komuna Bujan” në vlerën 112,500 lekë,

-“Rikonstruksion Rruge auto Qendër Komuna-Bllate, Komuna Bujan”, në vlerën 492,593 lekë.

c. Shoqëria “B...S” shpk vlerën 2,138,566 lekë për objektin “Sistemim Asfaltim Rruga auto Llugaj-Sopot, Komuna Llugaj”.

Menjëherë

22.-Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2013 deri më 31.07.2015, nga 6 ish komuna janë bërë pagesa për shpenzime udhëtim e dieta në mungesë të dokumentacionit autorizues dhe vërtetues, për ditë pushimi dhe feste për punonjësit e administratës dhe ish kryetarët e njësisve vendore, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën totale **881,000 lekë**. Konkretisht këto pagesa janë kryer në ish komunat: Llugaj në vlerën 315,500 lekë, Bytyç në vlerën 62,500 lekë, Fierzë në vlerën 402,500 lekë, Lekbibaj në vlerën 40,000 lekë, dhe Margegaj në vlerën 60,500 lekë.

22.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa, dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës **881,000 lekë** të përfituar padrejtësisht nga punonjësit e administratës dhe ish Kryetarët e Komunave sipas shumave të paraqitura në tabelat përkatëse, trajtuar në pikën IV/5/3 faqe 69-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

23.-Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2013-2015 janë kryer pagesa për shpenzime të telefonisë celulare për ish Kryetarin e Bashkisë Bajram Curri z. **A. D.** në vlerën 138,568 lekë dhe për ish Kryetarin Komunës Llugaj, z. **V. Ç.** në vlerën 149,982 lekë, në kundërshtim me pikën 9 dhe 11 të

VKM nr.864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, me pasojë dëm ekonomik në **vlerën 288,550 lekë**.

23.1-Rekomandim: Drejtoria ekonomike në bashkëpunim me sektorin juridik, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 288,550 lekë**, nga e cila vlera 138,568 lekë nga z. **A. D.**, me detyre ish-kryetar i Bashkisë Bajram Curri dhe vlera 149,982 lekë nga z. **V. Ç.** me detyre ish-kryetar i Komunës Llugaj.

Menjëherë

B.2. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Si rezultat i mos zbatimit të kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, dukë kualifikuar operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, si dhe për shkak të kryerjes së shpenzime për zhvillimin e aktiviteteve social-kulturore, në mungesë të programit të miratuar dhe në mungesë të bazës ligjore për këto shpenzime, janë krijuar **efekte negative në buxhet në vlerën totale 160,795 mijë lekë**, nga e cila vlera 159,220 mijë lekë në fushën e prokurimeve publike dhe vlera 1,575,250 lekë në fushën e aktiviteteve social-kulturore, konkretisht si më poshtë:

- Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluara në Bashkinë Tropojë dhe 7 ish komunitat, u konstatuan se 6 procedura prokurimi janë kryer në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24 “Anullimi i një procedure prokurimi” dhe pika 5 e nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, *pasi*:

Operatorët ekonomik janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të hartuara nga Njësia e Prokurimit e të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (këtu e në vijim AK), duke mos u anuluar këto procedura nga KVO dhe Titullari i AK. Këto veprime kanë sjellë shpenzime me efekt negativ në buxhet për vlerën totale të kontratës 159,220 mijë lekë, si rezultat i shpalljes fitues të operatorëve ekonomik në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura në DST e si rrjedhim nuk garantojnë cilësinë e punimeve në këto tendera.

Shkeljet e mësipërme janë konstatuar respektivisht:

- vlera 147,310 mijë lekë në Bashkonë Tropojë;
- vlera 9,747 mijë lekë në ish Komunën Margegaj;
- vlera 2,162 mijë lekë në ish Komunën Bujan.

Në këto raste janë favorizuar operatorët ekonomik në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe janë shpallur fitues me kriteret të paplota, *konkretisht*:

1.-Gjetje nga auditimi:

1.1.Në tenderin me objekt “*Sistemim-Asfaltim Lagjia ”28 Gushti”, Bashkia Tropojë*”, zhvilluar në vitin 2016, me vlerë të fondit limit 15,833 mijë lekë pa TVSH, kanë marrë pjesë dy OE të cilët nuk i plotësojnë kriteret e DST. Është shpallur fitues OE “**F...a**” sh p k, me vlerë të ofertës më të lartë dhe vlerë kontrate: **15,469 mijë lekë** pa TVSH, vlerë e cila përbën **efekt negativ në buxhet** për mos garantim të cilësisë së punimeve për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të DST.

1.2.Në tenderin me objekt “*Skema ujtitëse me rezervuarin Vlad, rehabilitim i pjesshëm*”, Bashkia Tropojë, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 22,366 mijë lekë pa TVSH, midis dy operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret, OE “**Sh...i**” shpk dhe OE “**V...i**” shpk, është shpallur

fitues OE “V...i” shpk, me vlerë të ofertës më të lartë dhe vlerë kontrate prej **22,352 mijë lekë** pa TVSH, e cila përbën **efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore.**

1.3. Në tenderin me objekt “*Rikualifikim urban i qendrës së qytetit B. Curri (lagje 28 Gushti) dhe ndërtim i tregut të punimeve artizanale*”, zhvilluar në vitin 2016, Bashkia Tropojë, me fond limit 13,738,804 lekë, midis dy operatorëve ekonomik të cilët nuk i plotësojnë kriteret, BOE ”Sh... M & N...a“ shpk dhe BOE “J...k” & “T...r” shpk, është shpallur fitues BOE “J...k” & “T...r” shpk, me vlerën të ofertës më të lartë dhe vlerë të kontratës **13,698 mijë lekë** pa TVSH, e cila përbën **efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore.**

1.4. Në tenderin me objekt “*Rehabilitim i Shëtitores së qytetit Bajram Curri, Bashkia Tropoje*”, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 124,39,926 lekë, midis dy operatorëve ekonomik të cilët nuk i plotësojnë kriteret, OE “C...i” shpk, dhe OE “Sh...I” shpk me vlerë të ofertës më të lartë, është shpallur fitues OE “Sh...I” shpk, me vlerë të kontratës **95,791 mijë lekë** pa TVSH, e cila përbën **efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore.**

1.5. Në tenderin me objekt “*Sistemim, asfaltim i rrugëve të brendshme të Komunës Margegaj, LOTI i dytë*”, zhvilluar në vitin 2014 nga ish Komuna Margegaj, midis dy OE të cilët nuk plotësojnë kriteret, OE “A...i” shpk, dhe OE “V...i” shpk, me vlerë më të lartë të ofertës, është shpallur fitues OE “V...i” shpk, me vlerë të kontratës **9,747 mijë lekë** pa TVSH, e cila përbën **efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore.**

1.6. Në tenderin me objekt “*Pastrim e mirëmbajtje gështenja faza e parë dhe e dytë*”, me fond limit 2,195,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2014, në ish Komunën Bujan”, midis dy OE të cilët nuk plotësojnë kriteret, OE “N...a” sh.p.k dhe OE “H...i” shpk, është shpallur fitues OE “H...i” shpk, me vlerë të ofertës më të lartë dhe vlerë të kontratës **2,162 mijë lekë** pa TVSH, e cila përbën **efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore.**

1.1.-Rekomandim: Bashkia Tropojë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative në buxhet në vlerën **159,220 mijë lekë** pa TVSH, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës, mallit dhe shërbimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.-Gjetje nga auditimi: Nga katër ish komuna janë kryer shpenzime për zhvillimin e aktiviteteve social-kulturore, në mungesë të programit të miratuar nga titullari, si dhe në mungesë të bazës ligjore për këto shpenzime, në vlerën totale **1,575,250 lekë**. Konkretisht ish-komunat: Bytyç në 3 raste në shumën 525,000 lekë, Llugaj në 1 rast në shumën 82,000 lekë, Fierzë në 3 raste në shumën 358,300 lekë, Bujan në 5 raste në shumën 609,950 lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4, pika 26, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35,36, **me pasojë efekt negativ në buxhet në vlerën 1,575,250 lekë.**

2.1-Rekomandim: Bashkia Tropojë, të marrë masa që organizimi i aktiviteteve social kulturore të bëhen në bazë projektesh, preventivash dhe kontratash.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA ADMINISTRATIVE

C.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)

I. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2016, si dhe përgjegjësisë individuale të

evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **7 punonjësve**, për procedurat e prokurimi, si më poshtë:

1. Z. A. M., me detyrë N/Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e kryetarit të KVO në Bashkinë Tropojë;

2. Z. Z. C. me detyrë drejtor i shërbimeve publike dhe turizmit, në cilësinë e anëtarit të KVO në Bashkinë Tropojë;

3. Z. R. I. me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e anëtarit të KVO në Bashkinë Tropojë, *për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:*
-Për mos zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 1 pika b/d/dh, nenin 2 pika a/b/c;nenit 53, pika 3 dhe 5, nenit 55, pika 1, germa a, në 4 raste, me pasojë impakt negativ ekonomik në buxhetin e bashkisë në **vlerën 147,310 mijë lekë** në tenderat e mëposhtëm:

a- Në tenderin me objekt “Sistemim-Asfaltim Lagjia 28 Gushti, qyteti Bajram Curri”, zhvilluar në vitin 2016”, me vlerë të fondit limit 15,833 mijë lekë pa TVSH me pasojë efekt negativ në buxhet në **vlerën 15,469 mijë lekë** pa TVSH.

b- Në tenderin me objekt “Skema ujitëse me rezervuarin Vlad, rehabilitim i pjesshëm”, Bashkia Tropojë, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit 22,366 mijë lekë pa TVSH, me pasojë efekt negativ në buxhet në **vlerën 22,352 mijë lekë** pa TVSH.

c- Në tenderin me objekt “Rikualifikim urban i qendrës së qytetit B.Curri (lagje 28 Gushti)dhe ndërtim i tregut të punimeve artizanale”, zhvilluar në vitin 2016, Bashkia Tropojë, me fond limit 13,738,804 lekë, me pasojë efekt negativ në buxhet në **vlerën 13,698 mijë lekë** pa TVSH.

d-Në tenderin me objekt “Rehabilitim i Shëtitores së qytetit Bajram Curri, Bashkia Tropojë”, zhvilluar në vitin 2016, me fond limit124,39,926 lekë, me pasojë efekt negativ në buxhet në **vlerën 95,791 mijë lekë** pa TVSH.

4. Z. E. M., me detyrë ish nënkryetar i komunës Margegaj, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, kompetencë e deleguar nga ish Kryetari i Komunës **z. R. B.**;

5. Z. P. C., me detyrë ish sekretar i këshillit të komunës Margegaj, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit;

6. Znj. S. I. me detyrë specialiste ndërtimi, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, ish Komuna Margegaj;

7. Z. A. I. me detyrë specialist i ndihmës ekonomike, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, ish Komuna Margegaj, *për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:*

Për moszbatim të ligjit 9643 “Për prokurimi publik”, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 33; të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 36, me pasojë shmangien e paargumentuar të procedurës elektronike të prokurimit dhe zgjedhjen e procedurës emergjente (shkresore), e cila nuk është procedurë konkurruese, në tenderin me objekt “Hapje rruge auto Kika-Çerem-Markofce-Bjeshkët, (heqje shembjesh, zgjerim rruge), Komuna Margegaj”.

II.Për përjashtim nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, të një operatori ekonomik;

Bazuar në nenin 13, pika3/a, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, ndryshuar, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, **përjashtimin nga procedurat e**

prokurimit publik të operatorit ekonomik "T...r" shpk për një periudhë 1 vjeçare, për deklarime të rreme, konkretisht si më poshtë:

OE "T...r" shpk, bazuar në ekstraktin e regjistrimit tregtar, të lëshuar nga QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) është themeluar si subjekt juridik i formës shpk, në datën 19.05.2016 dhe është regjistruar në QKB në datën 26.05.2016, dy muaj përpara zhvillimit të tenderit me objekt *"Rikualifikim urban i qendrës së qytetit B. Curri (lagje "28 Gushti") dhe ndërtim i tregut të punimeve artizanale", Bashkia Tropojë", viti 2016*. Në këtë tender ka lëshuar deklaratë të rreme nr.5, në të cilën deklaroi se përmbush specifikimet teknike të vendosura në DST, por që në fakt nuk i përmbush ato, konkretisht si më poshtë:

1. Nuk plotëson kërkesat e kapacitetit ekonomik, të përcaktuara në seksionin nr.2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", të DST:

a) Nuk disponon aktivitet dhe bilance për vitin 2013, 2014, 2015, kërkesë e germës (a).
b) Nuk disponon aktivitet dhe xhiro vjetore për vitet 2013, 2014, 2015, kërkesë e germës (b)

2. Nuk plotëson kërkesat e kapacitetit teknik, të kërkuar në DST:

a) Nuk ka realizuar gjatë tre viteve të fundit asnjë aktivitet ekonomik nëpërmjet të cilit të ketë kryer punë të ngjashme me atë të objektit të prokurimit, kërkesë e germës (a).

d) Nuk ka numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës, sipas zërave dhe përqindjes të përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit, kërkesë e germës (d).

e) Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në germën (e) "mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike", të seksionit "Kapaciteti teknik" të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në DST, pasi nuk ka numrin e nevojshëm të 5 mjeteve, por vetëm dy prej tyre, për shkak të mungesës së përvojës në punë të mëparshme të ngjashme, të qenurit një operatorë i porsa krijuar etj.

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-sëtë ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, "llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tropojë, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", për 12 punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. M. B., me detyrë përgjegjëse e planifikimit dhe zhvillimit të teritorit në Bashkinë Tropojë, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit (NJP), Bashkia Tropojë;

2. Znj. V. N., me detyrë specialiste juridike, në cilësinë e anëtares së NJP Bashkia Tropojë;

3. Z. B. H., me detyrë specialist finance, në cilësinë e anëtarit të NJP Bashkia Tropojë; për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

- Për mos zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenit 61, pika 2, paragrafi 2; të nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve", të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, sepse kriteret për kualifikimin të operatorëve ekonomik, nuk janë argumentuar dhe dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre., është vepruar me dy standarde për disa tendera duke mos kërkuar plotësimin e kriterëve të nevojshme sipas kërkesave të LPP, të cilat në tendera të tjerë janë

vendosur në DST, janë kërkuar kritere të cilat nuk lidhen me objektin e kontratës, apo që tejkalojnë kërkesat ligjore, të formuluar jo në përputhje me kërkesat e LPP. Këto mangësi janë konstatuar në tenderat e mëposhtëm me objekt:

- *Sistemim-Asfaltim Lagjja "28 Gushti", Bajram Curri, Bashkia Tropojë, me fond limit në vlerën 15,833,333 lekë, zhvilluar në vitin 2016;*
- *Ujësjiellësi i jashtëm i fshatit Tropojë e Vjetër dhe rrethinat, rrethi Tropojë", me fond limit në vlerën 15,833,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016;*
- *Skema ujitëse me rezervuarin Vlad, rehabilitim i pjesshëm, Bashkia Tropojë, me fond limit në vlerën 22,366,056 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2016.*
- *"Rikualifikim urban i qendrës së qytetit B.Curri (lagje "28 Gushti") dhe ndërtim i tregut të punimeve artizanale", Bashkia Tropojë", viti 2016.*
- *"Për efijçencën e energjisë për pallatin nr.2, Rr. Mic Sokoli, Lagjja Dardania", zhvilluar në vitin 2016.*

Znj. V. N., edhe për shkeljen e mëposhtme: në cilësinë e anëtares së grupit të punës për transferimin e dokumentacionit prej arkivave të komunës në Bashkinë Tropojë: për mos zbatim të plotë të kërkesave të VKM 510, datë 10.06.2015 dhe urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 18, datë 19.08.2015 në zbatim të VKM së mësipërme, me pasojë mos përfundimin ende të transferimit të dokumentacionit nga arkivat e ish komunave në arkivën e Bashkisë Tropojë.

4. Znj. V. B. me detyrë përgjegjëse finance në Bashkinë Tropojë, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për shkeljet e mëposhtme:

a- Për moszbatim të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 12, germa (g), pasi nuk ka kontabilizuar dhe marrë masa për arkëtim e vlerës 3,134,354 lekë për 5 masa organizative, dhe vlerës 15,686,081 lekë për 5 masave për shpërblim dëmi, të lëna në rekomandimet e KLSH, me shkresën nr. 772/9 prot., datë 09.12.2014.

b- Për mos zbatim të ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë", i ndryshuar, me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 480,000 lekë për arsye të pagesës së bonusit të transportit për 25 muaj për ish-Kryetarin e Bashkisë.

c- Për mos kontabilizimin e debitorve për taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Tropojë dhe mos marrjen e masave për arkëtimin e detyrimit të tyre në vlerën **4,055,530 lekë**, në kundërshtim me ligjin 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 12, germa (g), "Detyrat e nëpunësit zbatues".

e- Për mos kryerje të procesit të inventarizimit të plotë për vitin 2015 dhe mos kryerjes të këtij procesi për vitin 2016, në kundërshtim me: ligjin 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 12, germa (g), "Detyrat e nëpunësit zbatues"; Rubrikën IV-Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

5. Z. A. B. me detyrë specialist i taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e anëtarit të KPVV Bashkia Tropojë;

6. Z. P. R. me detyrë përgjegjës i sektorit të pastrimit, në cilësinë e anëtarit të KPVV Bashkia Tropojë, për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

a- Për mos zbatim të VKM nr 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu VI pika 2/a; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin rregullave të prokurimit publik", neni 40; Udhëzimit të APP nr. 03, datë 27.01.2015, për copëzim të fondeve dhe shmangien nga procedurat e prokurimit me vlera të larta në vlerën 7,430,027 lekë.

7. Znj. D. Gj. me detyrë përgjegjëse e sektorit të ndihmës ekonomike, në cilësinë e anëtarit të KPVV në ish Komunën Bujan; për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

a- Për mos zbatim të VKM nr 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu i VI pika 2/a; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin rregullave të

prokurimit publik”, neni 40; Udhëzimit të APP nr. 03, datë 27.01.2015, për copëzim të fondeve dhe shmangien nga procedurat e prokurimit me vlera të larta në vlerën 2,930,402 lekë lekë.

b- Në cilësinë e anëtares së KVO, për moszbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 1 pika b/d/dh, nenin 2 pika a/b/c;nenit 53, pika 3 dhe 5, nenit 55, pika 1, germa a në tenderin me objekt “*Pastrim e mirëmbajte gështenja faza e parë dhe e dytë*”, zhvilluar në vitin 2014 në ish Komunën Bujan, me pasojë efekt negativ në buxhet në vlerën 268,994 lekë.

8. Z. H. S. me detyrë specialist në sektorin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tropojë 28.02.2016 e në vazhdim, për shkeljet e mëposhtme:

a- Për arkëtimin e detyrimeve nga subjektet debitor, nuk janë ndjekur procedurat ligjore në zbatim të kërkesave të Kreun XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor*, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë për vlerën **4,055,530 lekë**. Nuk ka të dhëna të sakta për detyrimet për taksat dhe tarifave vendore për subjektet me aktivitet minerar, e veçanërisht për 15 prej tyre për të cilat ka të dhëna të pasakta e kontradiktore, duke i nxjerrë debitor në vlerën 1,163,902 lekë në regjistrin e taksapaguesve dhe nga ana tjetër nuk figurojnë në listën e debitorve. Nuk janë marrë masa për të qartësuar këtë situatë, si rakordime me subjektet etj. Nuk është përcjellë lista e debitorëve zyrtarisht në sektorin e financës për kontabilizim të detyrimeve.

b- Nuk është nxjerrë njoftim vlerësimi për arkëtimin e taksave familjare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 23 dhe Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr. 03, datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”, pika 52.

c- Nuk është krijuar regjistri për taksapaguesit familjar në Bashkinë Tropojë, në kundërshtim me pikën 7, neni 4 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

9. Z. K. O. me detyrë përgjegjës i BNJ Bashkia Tropojë, në cilësinë e ish inspektorit të taksave dhe tarifave vendore në Komunën Fierzë për periudhën 01.01.2013-31.07.2015;

10. Z. T. G. me detyrë përgjegjës i sektorit të zhvillimit rural, në cilësinë e ish inspektorit të taksave dhe tarifave vendore në ish Komunën Bujan për periudhën 01.01.2013-31.07.2015, për shkeljet e përbashkëta të mëposhtme:

-Nuk është krijuar regjistri për taksapaguesit familjar respektivisht në ish Komunën Fierzë dhe Bujan, në kundërshtim me pikën 7, neni 4 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

-Nuk është nxjerrë njoftim vlerësimi për arkëtimin e taksave familjare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 23 dhe Udhëzimit Plotësues të Buxhetit të Ministrit të Financave nr. 03, datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”, pika 52.

11. Z. G. S. me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve publike dhe kontrollit të teritorit, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për transferimin e dokumentacionit prej arkivave të komunës në bashki, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos zbatim të plotë të kërkesave të VKM 510, datë 10.06.2015 dhe urdhrin të Kryetarit të Bashkisë nr. 18, datë 19.08.2015 në zbatim të VKM së mësipërme, me pasojë mos përfundimin ende të transferimit të dokumentacionit nga arkivat e ish komunave në arkivën e Bashkisë Tropojë.

12. Z. H. Ç. me detyrë drejtor i planifikimit dhe zhvillimit të teritorit, për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos zbatim të plotë të kërkesave të VKM 510, datë 10.06.2015 dhe urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 18, datë 19.08.2015 në zbatim të VKM së mësipërme, me pasojë mos përfundimin ende të transferimit të dokumentacionit nga arkivat e ish komunave në arkivën e Bashkisë Tropojë.

-Për mos zbatim të VKM nr.2 datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” në zbatim të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe

disiplinimin e punimeve të ndërtimit", Kreu II, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 832,032 lekë, për arsye të llogaritjes në kosto edhe të TVSH së paisjeve në tenderin "Rikonstruksion i Bashkisë Tropojë.

- Për mos zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenit 61, pika 2, paragrafi 2, pasi kriteret për kualifikimin e operatorëve ekonomik, nuk janë argumentuar dhe dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Kjo mangësi është konstatuar në tenderat e mëposhtëm me objekt:

- *Sistemim-Asfaltim Lagjja "28 Gushti", Bajram Curri, Bashkia Tropojë, me fond limit në vlerën 15,833,333 lekë, zhvilluar në vitin 2016;*

- *Ujësjiellësi i jashtëm i fshatit Tropojë e Vjetër dhe rrethinat, rrethi Tropojë", me fond limit në vlerën 15,833,333 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016;*

- *Skema ujitëse me rezervuarin Vlad, rehabilitim i pjesshëm, Bashkia Tropojë, me fond limit në vlerën 22,366,056 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2016.*

D.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", shkronjat "e" dhe "ç" të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe **nenit 11 të kontratës individuale** të punës, datë 04.01.2016, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2015, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, **për 10 punonjësit e mëposhtëm:**

-"Vërejtje", për 7 punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. B. H. me detyrë administrator i NJA Bujan, në cilësinë e ish Kryetarit të Komunës Bujan dhe nëpunësit autorizues, *për shkeljet e mëposhtme:*

- Nuk ka mbikëqyrur veprimtarinë e punën e zyrës së taksave dhe tarifave vendore të Komunës, në kundërshtim me nenin 9, pika dh të ligjit 10296, datë 8.7.2010 "Për MFK".

-Për shpenzime të pa mbështetura në bazë ligjore në 5 raste për aktivitete social-kulturore, me efekt negative në buxhet në vlerën 609,950 lekë.

- Për mos zbatim të ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin e disiplinimin e punimeve të ndërtimit" neni 4,5,7,8 dhe12, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 605,093 lekë, për arsye të pagesës së projekt-preventivit, supervizimit dhe vlerës së kolaudit, kontraktorit.

2. Z. Z. H. me detyrë specialist i financës e arkivit, në cilësinë e anëtarit të KPVV në ish Komunën Bujan, *për shkeljet e mëposhtme:*

a- Për mos zbatim të VKM nr 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", kreu i VI pika 2/a; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin rregullave të prokurimit publik", neni 40; Udhëzimit të APP nr. 03, datë 27.01.2015, për copëzim të fondeve dhe shmangien nga procedurat e prokurimit me vlera të larta në vlerën 2,930,402 lekë lekë dhe në për 4 grup artikujsh të tjerë në vlerën 7,430,027 lekë

- Për moszbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 1 pika b/d/dh, nenin 2 pika a/b/c;nenit 53, pika 3 dhe 5, nenit 55, pika 1, germa a në tenderin me objekt "Pastrim e mirëmbajete gështenja faza e parë dhe e dytë", zhvilluar në vitin 2014 në ish Komunën Bujan, me pasojë efekt negativ në buxhet në vlerën **268,994 lekë**, në cilësinë e anëtarit të KVO.

3. Znj. Z. H. me detyrë punonjëse shërbimi, në cilësinë e anëtarit të KPVV në ish Komunën Bujan për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos zbatim të VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu i VI pika 2/a; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik”, neni 40; Udhëzimit të APP nr. 03, datë 27.01.2015, për copëzim të fondeve dhe shmangien nga procedurat e prokurimit me vlera të larta në vlerën 2,930,402 lekë lekë dhe në për 4 grup artikujsh të tjerë në vlerën 7,430,027 lekë

4. Z. M. H. me detyrë punonjës shërbimesh, në cilësinë e anëtarit të KPVV në ish Komunën Bytyç për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos zbatim të VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu i VI pika 2/a; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik”, neni 40; Udhëzimit të APP nr. 03, datë 27.01.2015, për copëzim të fondeve dhe shmangien nga procedurat e prokurimit me vlera të larta në vlerën 5,568,921 lekë.

5. Z. B. P. me detyrë punonjës shërbimesh, në cilësinë e anëtarit të KVO në ish Komunën Fierzë, për shkeljet e mëposhtme:

Për mos zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 1 pika b/d/dh, nenin 2 pika a/b/c;nenit 53, pika 3 dhe 5, nenit 55, pika 1, gërma a në tenderin me objekt “Rruga auto Degë-Rushtë (hapja e trasesë)” Komuna Fierzë, zhvilluar në vitin 2013, me pasojë efekt negativ në buxhet në vlerën **788,781 lekë.**

6. Z. E. A. me detyrë punëtor shërbimesh, në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkeljet e mëposhtme:

Për mos zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 1 pika b/d/dh, nenin 2 pika a/b/c;nenit 53, pika 3 dhe 5, nenit 55, pika 1, germa a në tenderat e mëposhtëm:

a- Në tenderin me objekt “Sistemim, asfaltim i rrugëve të brendshme të Komunës Margegaj, LOTI i parë: Sistemim asfaltim i segmentit Dedaj-Gelaj-Shoshan 3481 ml”, zhvilluar në datën 12.05.2014, duke kualifikuar OE i cili nuk i plotëson kriteret e DST.

b-Në tenderin me objekt “Sistemim, asfaltim i rrugëve të brendshme të Komunës Margegaj, LOTI i dytë: Sistemim asfaltim segmenti fshati Paqe-Mustavataj, gjatësia 2300 ml”, zhvilluar në datën 02.05.2014, me pasojë efekt negativ në buxhet në vlerën 709,194 lekë

7. Z. F. H. me detyrë administrator i NJA Bytyç, në cilësinë e ish Kryetarit të Komunës Bytyç, për shkeljet e mëposhtme:

- Nuk është hartuar paketë fiskale për taksat dhe tarifave vendore për periudhën 2013-2015, në kundërshtim me nenin nr.5 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenin 9, pika d të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për MFK”.

- Nuk është mbikëqyrur veprimtaria e punën së zyrës së taksave dhe tarifave të Komunës, në kundërshtim me nenin 9, pika dh të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për MFK”.

- Për mos zbatim të ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shpërblimin shoqëror”, i ndryshuar, neni 29 pika 9, neni 31/c; VKM nr.787 datë 11.12.2005 “Për përcaktimin e procedurave të ndihmës ekonomike” i ndryshuar, me pasojë efekt negativ në buxhet në vlerën **198,000lekë** për ndihmë të menjëhershme për familjet në nevojë, në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ligjor.

- Për shpenzime të pa mbështetura në bazë ligjore në 3 raste për aktivitete social-kulturore, me efekt negative në buxhet në vlerën **525,000 lekë.**

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 3 punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. R. K. me detyrë ish Kryetar i Komunës Tropojë Fshat, aktualisht administrator i kësaj njësie administrative, për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk janë zbatuar rekomandimet e KLSH, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 158, datë 03.12.2014, konkretisht:

- Nuk janë zbatuar 6 masa organizative, një prej të cilave ka detyrimin për arkëtimin e vlerën 488,920 lekë.

- Nuk janë zbatuar pesë masa për shpërblim dëmi në vlerën 20,760,313 lekë.

- Nuk është mbikëqyrur veprimtaria e punën së zyrës së taksave dhe tarifave vendore të Komunës, në kundërshtim me nenin 9, pika dh të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për MFK”.

-Për mos zbatim të ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shpërblimin shoqëror”, i ndryshuar, neni 29 pika 9, neni 31/c; VKM nr.787 datë 11.12.2005 “Për përcaktimin e procedurave të ndihmës ekonomike” i ndryshuar, me pasojë efekt negativ në buxhet në vlerën **1,938,000 lekë** për ndihmë të menjëhershme për familjet në nevojë, në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ligjor.

2. Z. S. S. me detyrë punonjës shërbimesh në NJA Bytyç, në cilësinë e ish inspektor i taksave dhe tarifave vendore në ish Komunën Bytyç për periudhën 01.01.2013-31.07.2015, *për shkeljet e mëposhtme:*

a- Nuk është nxjerrë njoftim vlerësimi për arkëtimin e taksave familjare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 23 dhe Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr. 03, datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”, pika 52.

b-Nuk është krijuar regjistri për taksapaguesit familjar në ish Komunën Bytyç, në kundërshtim me pikën 7, neni 4 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

c- Nuk janë administruar listat e debitorëve privat dhe gjithashtu nuk është përcjellë lista e tyre në Bashkinë Tropojë me mbylljen e aktivitetit të komunës, në kundërshtim me detyrën funksionale.

d- Në cilësinë e anëtarit të KPVV në ish Komunën Bytyç, për mos zbatim të VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu i VI pika 2/a; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik”, neni 40; Udhëzimit të APP nr. 03, datë 27.01.2015, për copëzim të fondeve dhe shmangien nga procedurat e prokurimit me vlera të larta në vlerën 5,568,921 lekë.

3- Z. S. T. me detyrë punonjës shërbimesh në NJA Tropojë Fshat, në cilësinë e ish inspektorit të taksave dhe tarifave vendore në ish Komunën Tropojë Fshat për periudhën 01.01.2013 deri më 31.07.2015, *për shkeljet e mëposhtme:*

a- Nuk është nxjerrë njoftim vlerësimi për arkëtimin e taksave familjare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 23 dhe Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr. 03, datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”, pika 52.

b-Nuk është krijuar regjistri për taksapaguesit familjar në ish Komunën Tropojë Fshat, në kundërshtim me pikën 7, neni 4 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

c- Nuk janë administruar listat e debitorëve privat dhe gjithashtu nuk është përcjellë lista e tyre në Bashkinë Tropojë me mbylljen e aktivitetit të komunës, në kundërshtim me detyrën funksionale.

E. Për Punonjësit e Larguar

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte përkatësisht:

“Vërejtje”, për 3 ish punonjësit e mëposhtëm:

1. **Z. A. H.** me detyrë ish përgjegjës finance, në ish Komunën Bytyç, në cilësinë e titullarit të AK.
2. **Z. K. B.**, me detyrë specialist i taksave.
3. **Z. N. A.** me detyrë ish inspektor i taksave në Komunën Margegaj.

-Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna për 12 ish punonjësit e mëposhtëm:

4. **Z. Gj. P.** me detyrë ish Kryetar i Komunës Fierzë, në cilësinë e titullarit të AK.
5. **Z. A. D.** me detyrë ish Kryetar i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e titullarit të AK.
6. **Z. Gj. N.** me detyrë përgjegjës i financës në ish Komunën Lekbibaj.
7. **Znj. A. H.** me detyrë ish përgjegjëse e financës në ish Komunën Tropojë Fshat, në cilësinë e NZ.
8. **Znj. S. Q.** me detyrë ish përgjegjëse e financës në ish Komunën Bujan, në cilësinë e NZ.
9. **Z. S. I.** me detyrë ish përgjegjës i financës në ish Komunën Fierzë, në cilësinë e NZ.
10. **Z. R. D.** me detyrë ish specialist finance në Bashkinë Tropojë.
11. **Z. B. B.** me detyrë ish specialist i ndihmës ekonomike në Bashkinë Tropojë.
12. **Z. Xh. M.** me detyrë ish specialist i degës teknike, shërbimeve dhe kadastrës në ish Komunën Llugaj.
13. **Z. A. N.** me detyrë ish specialist i ndihmës ekonomike në ish Komunën Lekbibaj.
14. **Z. V. L.** me detyrë ish jurist në ish Komunën Lekbibaj.
15. **Z. A. D.** me detyrë specialist ndërtimi në ish komunën Bujan.

- Zgjidhje e kontratës së punës, për 10 ish punonjësit e mëposhtëm:

16. **Z. R. B.** me detyrë ish Kryetari i Komunës Margegaj, në cilësinë e titullarit të AK.
17. **Z. G. M.** me detyrë ish Kryetari i Komunës Lekbibaj, në cilësinë e titullarit të AK.
18. **Z. V. Ç.** me detyrë ish Kryetar i Komunës Llugaj, në cilësinë e titullarit të AK.
19. **Znj. V. A.** me detyrë ish përgjegjëse e zyrës taksave dhe tarifave vendore Bashkia Tropojë.
20. **Z. M. Ç.** me detyrë ish inspektor i taksave në Komunën Llugaj.
21. **Znj. V. Rr.** me detyrë ish përgjegjëse e financës në ish Komunën Lekbibaj, në cilësinë e NZ.
22. **Z. A. H.** me detyrë ish përgjegjës i financës në ish Komunën Bytyç në cilësinë e NZ.
23. **Z. A. O.** me detyrë ish përgjegjës i financës në ish Komunën Llugaj, në cilësinë e NZ.
24. **Znj. S. B.** me detyrë teknike ndërtimi në ish Komunën Margegaj, në cilësinë e anëtares së NJP.
25. **Znj. N. D.** me detyrë ish inspektore tregu.

- Largim nga shërbimi civil për 1 ish punonjës:

26. **Znj. Z. I.** me detyrë ish përgjegjëse e financës në ish Komunën Margegaj, në cilësinë e NZ.

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Tropojë, Njësia e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

G . KALLËZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e nenit 248 "Shpërdorimi i detyrës" të Kodit Penal dhe ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", VKM nr. 1 datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" kreu VI pikës 2/a; me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin rregullave të prokurimit publik" neni 40; me UMF nr. 33, datë 11.07.2013 dhe UMF nr. 57 datë 12.06.2014 "Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë" tabela 1/3, me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" neni 4/26, me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik" pika 35,36,38,52,54, bëjmë kallëzim penal për 3 personat si më poshtë:

- 1.Z. R.B.** me detyrë ish Kryetar i Komunës Margegaj dhe në cilësinë e nëpunësit autorizues;
- 2.Znj. Z.I.** me detyrë ish përgjegjëse e financës së Komunës Margegaj dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues.
- 3.Znj. Z.I.** me detyrë specialiste e zyrës së gjendjes civile, ish Komuna Margegaj, sot po në këtë Njësi Administrative.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

BUJAR LESKAJ

K R Y E T A R